



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
Sektori i Aseteve

Projekt Vendim

Nr 03. Datë 31.01.2022

Për miratimin e rinovimit të kontratës së dhënies me qira të pasurisë nr 663 (pjesë), Zk nr 2708, për antenë celulare, në fshatin Mnelë e Vogël, subjektit “ALBtelecom” Sha.

Mbështetur në Ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 3, ligji nr 38/2019, ligji nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, ndryshuar. Në VKM nr 10, dt 07.01.2005, “Për miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore, në Komunën Vig Mnelë”, në VKM nr 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” ndryshuar, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të:

VENDOSI :

1. Miratimin e rinovimit të kontratës me afat 1 vjeçar, me të drejtë rinovimi, të dhënies me qira të pasurisë nr 663 (pjesë), Zk 2708 me sipërfaqe 150 m2, për antenë celulare, subjektit ALBtelecom Sha, e cila ka përfunduar afatin me datë 13.01.2022.
2. Efektet: Jep impakt pozitiv në komunitet, si dhe sigurohen të ardhura për Bashkinë, që kthehen në investime publike.
3. Vlera vjetore e dhënies me qira të jetë 324 000 lekë, sipas kontratës pararendëse, bazuar në VKM-së Nr 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

KRYETARI
Mark BABANI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/ KRYETARI
Lestinë NDOJA



Konceptoi: Armand Filipi
Miratoi: Ndoc Baqli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
Sektori i Aseteve

Nr 511/1-Prot

Vau Dejës me 03.02-2021

RELACION

MBI RINOVIMIN E KONTRATES PËR DHËNIE NË PËRDORIM SUBJEKTIT
“ALBTELEKOM”, Sh.a, STACIONI NR SH 1008 MNELË E VOGËL PËR ANTENË TË
TELEFONISË CELULARE

Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Vau Dejës, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, është edhe dhënia në përdorim me apo pa konkurim e pronave të saj, të tretëve.

Kontrata nr 6675 prot, datë 22.11.2021, e lidhur mes Bashkisë Vau Dejës dhe Shoqërisë “Albtelekom” sha.a, ka përfunduar afatin e saj me datë 13.01.2021, bazuar në vullnetin dhe dakordësinë e palëve kërkohet rinovimi i kësaj kontrate për përdorimin e truallit në pasurinë nr 663, Zk 2708 ne fshatin Mnelë e vogël, stacioni nr SH1008. Kjo kontrate ka qenë e lidhur me afat 1 vjeçar, me vlerë vjetore = 324 000 lekë, llogaritur sipas VKM nr 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar..

Bazuar në sa më sipër, propozojmë miratimin e rinovimit të kësaj kontrate, me afat 1 vjeçar, me të drejtë rinovimi për shfrytëzimin e sipërfaqes së truallit të dhënë me qira, pjesë e pasurisë nr 663, Zk 2708, sipas kushteve dhe objektit të kontratës pararendese.

Duke ju falenderuar, ju ftojme të miratoni projekt vendimin.

Konceptoi: Armand Filipi

Miratoi: Ndoc Baqli



BASHKIA VAUDEJËS

Nr 6675 prot

Vau Dejës, me 22. 11. 2021

ALBtelecom Sh.a

Nr 777 prot

Tiranë me 23. 12 2021

KONTRATË QIRAJE

PËR

DHËNIEN NË PËRDORIM TË PASURISË SË LLOJIT TRUALL

Në zbatim të ligjit nr 139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", ndryshuar, ligji nr 8744, datë 22.02.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar, VKM nr 10, datë 07.01.2005, "Për miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Vig Mnelë", neni 801 e në vazhdim i ligjit nr 7850 datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, VKM nr 54 datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyres së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës **Nr 61, datë 26.10.2021**, "Për miratimin e rinovimit të kontratës së dhënies me qira të pasurisë së llojit Truall, për antenën e transmetimit të telefonisë celulare, subjektit "ALBtelecom", lidhet kjo kontratë mes palëve;

I.PALËT:

Bashkia Vau Dejës, e përfaqësuar nga Kryetari z. **Mark BABANI**, që këtu e më poshtë do të quhet "Qiradhënësi", dhe subjekti;

ALBtelecom sh.a. shoqëri anonime shqiptare, regjistruar si person Juridik në bazë të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 20820, datë 16.02.1999, me seli në adresën Rruga; Muhedin Llagami, Kompleksi Square 21, Tiranë, Shqipëri, me Nr NIPTi J61824053N me Administrator Znj.Bilgen ALDAN, shtetase turke, lindur në Turqi, më datë 14.01.1981 dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e Dokumentit të Identifikimit Pasaportë me Numër: U 12962516, që këtu e më poshtë do të quhet "Qiramarrësi" ;

Qiradhënësi dhe ALBtelecom Sha/Qiramarrësi më poshtë do të quhen individualisht "Pala", ose bashkarisht "Palët".

II.DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Duke qenë se ekzistojnë kushtet paraprake të cilat bëjnë pjesë integrale të kësaj kontrate. Palët bien dakord si vijon;

1.Kushtet Paraprake dhe Shtojcat

Kushtet paraprake ashtu si dhe Shtojcat përbëjnë pjesë integrale të saj.

2.Përcaktime.

Sipërfaqe përdorimi; Vendi në të cilin do të ushtrohet aktiviteti për qëllime biznesi nga ana e subjektit, përcaktuar si **Stacioni Mnelë e vogël.**

Rrugë Kalimi/E drejta e kalimit; Rruga nga rruga kryesore për të hyrë në sipërfaqen e marrë në përdorim, është në pronësi të qiradhënësit dhe i shërben subjektit për të hyrë tek prona.

Neni 1

Objekti i Kontratës.

Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e pasurisë shtetërore e llojit Truall, pjesë e pasurisë nr 663, Zk 2708, me sipërfaqe 150 m2, në fshatin Mnelë e vogël, pronë e Bashkisë Vau Dejës, me çertifikatë pronësie nr 2045946, lëshuar me datë 28.04.2020, subjektit "ALBtelecom" Sha, për vendosje antenash të telefonisë celulare, në përputhje me Vendimin nr 61, datë 26.10.2021, të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Vau Dejës, "Për miratimin e dhënies në përdorim me afat 1 vjeçar me të drejtë rinovimi, të nje sipërfaqe 150 m2, pjesë e pasurisë nr 663, Zk 2708, e llojit Truall, subjektit "ALBtelecom" Sha, për antenat dhe paisjet e tjera të telefonisë celulare".

Neni 2

Qëllimi i përdorimit;

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm i pasurisë shtetërore të përcaktuar në nenin 1 të kësaj kontrate, për ushtrimin e veprimtarisë "**antene e telefonisë celulare**".

Neni 3

Kohëzgjatja;

3.1 Kjo kontratë është e vlefshme për 1 vit, duke filluar nga data 14.01.2021 deri më 13.01.2022, me të drejtë rinovimi mbi bazën e marrëveshjes reciproke mes palëve.

3.2 Palët mund të bien dakord për zgjatje të afatit të kontratës, duke njoftuar njera tjetren me shkrim 30 ditë para mbarimit të kësaj kontrate.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e Qiradhënësit;

4.1 Qiradhënësi siguron gëzimin e qetë të pronës objekt i kësaj kontrate dhe rrugës që çon tek prona Qiramarrësin, 24 ore për 7 dite të javës për kalimin e punonjësve, dhe të mjeteve, me paisjet përkatëse.

4.2 Qiradhënësi nuk do të bëjë asnjë ndryshim apo ndërtim, që mund të bëhet pengesë apo vështirësojë aktivitetin e Qiramarrësit. Në rast të ndryshimeve apo planeve për ndërtime, Qiradhënësi njofton me shkrim 3(tre) muaj para Qiramarrësin dhe merr miratimin paraprak të tij për spostimin e antenave. Në të tilla raste kostot e spostimit, paguhen nga qiradhënësi.

4.3 Qiradhënësi ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e Qiramarrësit.

4.4 Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 30 ditë përpara me shkrim.

4.5 Qiradhënësi nuk është i detyruar të garantojë Qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve, që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

4.6 Qiradhënësi nuk do të kërkojë në asnjë mënyrë përgjatë afatit kohor të kësaj kontrate, ndryshimin e çmimit të qirasë.


Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e Qiramarrësit

5.1 Qiramarrësi ka të drejte që në bazë të legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, vetëm për qëllimet e parashikuara dhe për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

5.2 Qiramarrësi ka për detyrë të përdorë pronën, dhe të realizojë aktivitetin për qëllimin e parashikuar në nenin 2 të kësaj kontrate, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar.

5.3 Qiramarrësi detyrohet të mos e dëmtojë, por ta shfrytëzojë dhe të bëjë përpjekje për ta mirëmbajtur sa më mirë pronën e marrë me qira.



Neni 6

Pagesa e Qirasë

6.2 Qiramarrësi do ti paguajë Qiradhënësit detyrimin vjetor të kontratës, në vlerën **324 000** (treqindnjëzetekatërmijë) **lekë/vit**, përkundrejt lëshimit të faturave tatimore përkatëse.

6.3 Pagesa e qirasë do të jetë një herë në 6 muaj parapagim, brenda datës 10 të muajit të parë të periudhës 6 mujore, dhe do të bëhet në llogarinë bankare të Qiradhënësit, sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

6.4 Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete (gjoha dhe kamatëvonesa), "Qiramarrësi" do të likujdojë vlerat e krijuara në llogarinë e "Qiradhënësit", sipas faturës tatimore të lëshuar nga ky i fundit.

Neni 7

Zgjidhja e Kontratës

7.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të parashikuar në nenin 3 të kësaj kontrate.

7.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit;

- a) me marrëveshje mes palëve.
- b) kur prona humbet tërësisht, ose dëmtohet për shkak të një force madhore.
- c) kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenet 5 dhe 6 të kësaj kontrate.
- ç) kur prona nevojitet për interes publik.
- d) kur prona kalon në procedurë privatizimi


7.3 Kontrata pushon së vepruari kur qiramarrësi nuk kryen pagesën e qirasë, të parashikuar në nenin 6 të kësaj kontrate, dhe detyrohet të dorëzojë objektin 15 ditë mbas marrjes së njoftimit me shkrim nga Qiradhënësi, për zgjidhjen e kontratës.

7.4 Kontrata pushon automatikisht së vepruari 30 ditë pas njoftimit me shkrim të qiradhënësit për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas nenit 7.2 të saj, dhe nëse qiramarrësi nuk ka reaguar me shkrim.

Neni 8

Përgjegjësitë e palëve

Adresa: Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail: info@vudejes.gov.al



8.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

8.2 Me "forcë madhore" do të kuptojmë një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si tërmetet, përmytjet, lufta. Në këto raste, palët janë të detyruara të njoftojnë njera tjetren me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjasë për aq kohë sa zgjasin këto rrethana.

8.3 Qiramarrësi përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhdimit të forcës madhore dhe moskryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhë do përcaktohet me marrëveshje mes palëve.

Neni 9

Dispozita të fundit

9.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do tu referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

9.2 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate, do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë ti drejtohen Gykatës së Rrethit Gjyqësor.

9.3 Në çdo rast të kalimit të mosmarrëveshjeve të lindura mes palëve në juridiksion gjyqësor, autorizohet njesia administruese dhe monitoruese e kontratës, për ndjekjen e procedurës gjyqësore.

Neni 10

Kjo kontratë është formuluar në katër kopje origjinale, në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet rregullisht nga palët.

QIRADHËNËSI
BASHKIA VAU DEJËS
KRYETARI
MARK BABANI



QIRAMARRËSI
ALBtelecom Sh.a
PËRFAQËSUESI
Bilgen ALDAN
Administrator

